



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Bazuar në nenin 49 par 3 të Ligjit për Avokatinë lidhur me nenin 83 par.2 lidhur me nenin 123 të Statutit të OAK, Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës në seancën e mbajtur më 28 dhjetor 2013 nxjerr:

RREGULLOREN PËR SPECIALIZIME

Kapitulli I

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i Rregullore është të përcaktoj kushtet, kriteret, afatet, autoritetin përgjegjës për dhënien e specializimit në degën përkatëse.

Neni 2

Specializimi i avokateve

Në përputhje me Statutin e Odës së Avokatëve të Kosovës, titulli i specialistit pranohet në këto degë:

1. E drejta kushtetuese,
2. E drejta penale,
3. E drejta civile,
4. E drejta administrative,
5. E drejta e punës,
6. E drejta komerciale
7. E drejta bankiere,
8. E drejta e pronësisë intelektuale,
9. E drejta ndërkombëtare
10. Drejtësia për të mitur

Neni 3

Parimet e përgjithshme

1. Asnjë Rregullore, Statut apo akt tjetër normativ i Odës së Avokatëve të Kosovës nuk do ta kufizoj të drejtën e avokatit, zyrës së avokatëve apo shoqëritë e avokatëve që të ofroj ndihmë juridike në të gjitha degët, pavarësisht nëse ka specializim apo jo.
2. Asnjë avokati, zyrës së avokatëve apo shoqëritë e avokatëve, nuk do të kërkohet të ketë specializim me qëllim që të ofroj ndihmë juridike në një degë të caktuar.

Neni 4

Kushtet për fitimin e specializimit

1. Kandidati për specializim në degën përkatëse, duhet që para aplikimit për specializim, të ketë një përvojë substanciale në degën përkatëse përgjatë pesë (5) viteve të fundit para

parashtrimin të kërkesës për specializim. Përvoja substanciale matet me llojin dhe numrin e rasteve në të cilat avokati ka ofruar ndihmë juridike, përkatësisht, nëse 25% e lëndëve nga totali i përgjithshëm i takojnë një degë të caktuar.

2. Për dhënien e titullit të avokatit i specializuar kandidati duhet të dëshmojë sipas dispozitave vijuese njohuri të posaçme teorike dhe përvoja të posaçme praktike.

Neni 5

Fitimi i njohurive teorike

1. Avokati që është kandidat për fitimin e titullit të specialistit, duhet që gjatë tre (3) viteve të fundit para parashtrimin të kërkesës për specializim, të ketë grumbulluar 12 kredi nga AVLO nga dega ku aplikon për specializim.
2. Kandidati mund të paraqes dëshmi për kurse, seminare, specializime të ndjekura jashtë AVLO-s, njohuritë e posaçme teorike të fituara jashtë AVLO-s që mund të llogariten si kredi pas vlerësimit nga ana e Komisionit Vlerësues.
3. Avokati që ka shërbyer në të kaluarën si Gjyqtar, Prokuror, Profesor në Fakultetin Juridik apo në ndonjë pozitë tjetër ku ka qenë i angazhuar pra ka shërbyer në një degë të caktuar të specializimit, pasi të ketë sjellë dëshmi për veprimtarinë e ushtruar në degën përkatëse, lirohet nga detyrimi i paraparë në Nenin 5 paragrafi 1.
4. Avokati që disponon me titull shkencor Magjistër apo Doktor në lëminë përkatëse, me kusht që titulli është i akredituar nga Ministria e Arsimit, lirohet nga detyrimi i paraparë në Nenin 5 paragrafi 1.

Neni 6

Përvoja praktike

1. Fitimi i përvojave të posaçme praktike është i kushtëzuar me atë që kandidati brenda 5 (pese) viteve të fundit para parashtrimin të kërkesës të ketë punuar personalisht në lëmin për të cilin kërkon specializimin si avokat:
 - (1) E Drejta Kushtetuese - 50 raste te cilat ka përfaqësuar para Gjykatës Kushtetuese.
 - (2) E Drejta Penale - 60 raste ne te cilat ka përfaqësuar nga fillimi i hetimeve deri ne marrjen e vendimit te shkalles se pare.
 - (3) E Drejta Civile – 80 raste ne te cilat ka përfaqësuar nga inicimi i procedurës deri ne marrjen e vendimit te shkalles se pare.
 - (4) E Drejta Administrative - 80 raste, prej tyre së paku 30 procedura gjyqësore.
 - (5) E Drejta e Punës - 80 raste, prej tyre së paku 30 procedura gjyqësore.
 - (6) E Drejta Komerciale – 80 raste, prej tyre së paku 30 procedura gjyqësore.
 - (7) E Drejta Bankiere - 80 raste, prej tyre së paku 30 procedura gjyqësore.

- (8) E Drejta e pronësisë intelektuale – 80 raste, , prej tyre së paku 30 procedura gjyqësore.
- (9) E Drejta Ndërkombëtare 50 raste te Arbitrazhit ndërkombëtar.
- (10) Drejtësia për të mitur 60 raste ne te cilat ka përfaqësuar nga inicimi i procedurës penale deri ne marrjen e vendimit te shkalles se pare.

Neni 7

Provimi me shkrim

Për marrjen e specializimit kandidatet i nënshtrohen provimit me shkrim nga lemia përkatëse.

Neni 8

Afati për marrjen e vendimit

1. Komisioni brenda 7 ditëve nga mbajtja e provimit me shkrim, do të njoftoj Këshillin Drejtues me shkrim duke ja bashkangjitur Arsyetimin, për dhënien apo mosdhënien e titullit të specializimit në degën përkatëse.
2. Këshilli Drejtues brenda afatit prej 30 ditëve nga pranimi i Njoftimit, do ta informoj kandidatin në lidhje me vendimin e Komisionit Vlerësues.

Kapitulli II

Njohuritë në Degët e Specializimit

Neni 9

Njohuritë e posaçme në të Drejtën Kushtetuese

Për degën në të Drejtën Kushtetuese, duhet të dëshmohen njohuri nga:

1. Kushtetuta e Kosovës
2. Procedura para Gjykatës Kushtetuese
3. Konventat ndërkombëtare te Aplikueshme ne Kosovës

Neni 10

Njohuritë e posaçme në të Drejtën Penale

Për degën në të Drejtën Penale, duhet të dëshmohen njohuri nga:

1. E Drejta Penale Materiale
2. E Drejta Penale Procedurale

Neni 11

Njohuritë e posaçme në të Drejtën Civile

Për degën në të Drejtën Civile duhet të dëshmohen njohuri nga:

1. Pjesa e përgjithshme
2. E Drejta Sendore
3. E Drejta Familjare
4. E Drejta Trashëgimore
5. E Drejta e Detyrimeve
6. E Drejta e Procedurës Civile

Neni 12

Njohuritë e posaçme në të Drejtën Administrative

Për degën në të Drejtën Administrative duhet të dëshmohen njohuri nga:

1. E Drejta e Përgjithshme Administrative;
2. Procedura Administrative;
3. Konflikti Administrativ

Neni 13

Njohuritë e posaçme në të Drejtën e Punës

Për degën në të Drejtën e Punës, duhet të dëshmohen këto njohuri nga :

1. E Drejta individuale e punës
 - 1.1 lidhja, përmbajtja dhe ndryshimi i kontratës së punës
 - 1.2 ndërprerja e marrëdhënies së punës,
 - 1.3 mbrojtja e grupeve të personave të caktuar, sidomos të shtatzënave dhe të nënave, të invalidëve të rëndë dhe të rinjve,
2. E drejta kolektive e punës
 - 2.1 e drejta e kontratave kolektive,
 - 2.2 e drejta e përfaqësimit të personelit dhe e drejta e statutit të ndërmarrjes,
 - 2.3 parimet themelore të së drejtës së luftës sindikale dhe të drejtës së marrjes së përbashkët të vendimeve,
3. e drejta procedurale.

Neni 14

Njohuritë e posaçme në të Drejtën Komerçiale

Për degën në të Drejtën Komerçiale, duhet të dëshmohen këto njohuri nga :

1. Shoqëritë Tregtare
2. Falimentimi, likuidimi dhe riorganizimi i personave juridik.
3. Konkurrenca
4. Investimet e huaja
5. Koncesionet
6. Kontratat Komerçiale
7. Zgjidhja jashtëgjyqësore e kontesteve ekonomike

Neni 15

Njohuritë e posaçme në të Drejtën Bankiere

Për degën në të Drejtën Bankiere, duhet të dëshmohen këto njohuri nga :

1. Lidhjet afariste mes bankës dhe klientëve, sidomos
 - 1.1 kushtet e përgjithshme të kontratës,
 - 1.2 kontratat bankare,
2. E Drejta e Tregut të Kapitalit dhe e investimeve kapitale, sidomos tregtia me letra me vlerë, afarizmi investues, format alternative të investimit, administrimi i pasurisë, ruajtja e pasurisë,
3. Faktoringu/lizingu,
4. Pastrimi i parave, mbrojtja e të dhënave, kompensimi i bankave,

Neni 16

Njohuritë e Posaçme nga e Drejta e Pronësisë Intelektuale

Për degën në të Drejta e Pronësisë Intelektuale duhet të dëshmohen këto njohuri nga:

1. Markat Tregtare
2. Të Drejtat e Autorit
3. Patenta
4. Dizajni Industrial

Neni 17

Njohuritë e posaçme në të Drejtën Ndërkombëtare

Për degën në të Drejtën Ndërkombëtare duhet të dëshmohen këto njohuri nga :

1. Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut
2. E Drejta Ndërkombëtare Publike
3. E Drejta Ndërkombëtare Private

Neni 18

Njohuritë e posaçme në të Drejtën për të Mitur

1. Kodi i Drejtësisë për të Mitur
2. Kodi procedurës penale
3. Konventa për të drejtat e fëmijëve

Kapitulli III

Komisioni Vlerësues

Neni 19

Përbërja e Komisionit

1. Këshilli Drejtues për çdo lëmi formon një Komision Vlerësues prej 5 anëtarëve, te cilët duhet të kenë ekspertizë me së paku 10 vjet përvojë pune në degën përkatëse të specializimit.
2. Vendimet e Komisionit merren me shumicë të kualifikuar, Vendimi i marr nga Komisioni është valid nëse pro Vendimit kanë votuar 4 anëtarë.

Neni 20

Kompensimi

Anëtarëve të Komisionit Vlerësues do të ju caktohet një kompensim financiar nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

Neni 21

Parashtrimi i kërkesës

- (1) Kërkesa për titullin e avokatit të specializuar duhet të parashtrohet te Oda e Avokatëve të Kosovës.
- (2) Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten dëshmi për kriteret e parapara sipas nenit 6 dhe 7 të kësaj Rregullore.

Neni 22

Procedura e mëtejme

- (1) Drejtori ekzekutiv verifikon se a janë të plota dokumentet e kërkesës.

- (2) Pasi qe Drejtori ekzekutiv verifikon se kërkesa e kandidatit është e kompletuar atë, se bashku me dokumentacionin e bashkangjitur ia dorëzon Kryetarit te Komisionit, i cili e cakton raportuesin e rastit, sipas sistemit rotativ.
- (3) Në procedurën me shkrim, raportuesi pas verifikimit formal dhe përmbajtjesor të dëshmive jep një mendim të arsyetuar për Kërkesën, se a i ka dëshmuar kandidati njohuritë e posaçme teorike dhe përvojat e posaçme praktike apo a janë të nevojshme dëshmi të tjera. Mendimi i raportuesit i dërgohet anëtarëve të tjerë të komisionit dhe Kryetarit i cili jep mendimin me shkrim. Paragrafi 4 vlen në mënyrë përkatëse.
- (5) Kryetari i komisionit, nga data e pranimt të dokumentacionit me kusht qe dokumentacioni plotëson kushtet e parapara në nenin 5 dhe 6 të kësaj Rregullore, brenda afatit prej 14 (katërbëdhjetë) ditëve cakton dhe njofton Kandidatin për datën e provimit.
- (6) Vlerësimi për dhënien/mosdhënien e provimit duhet të bëhet brenda 2 (dy) ditëve.
- (7) Komisioni vendos për mendimin e tij përfundimtar me shumicën e kualifikuar të votave të tij.
- (8) Kryetari ia bënë të njohur me shkrim mendimin përfundimtar të komisionit Këshillit Drejtues te Odës. Në rast të kërkesës së Këshillit Drejtues, Kryetari i Komisionit ose zëvendësi i tij e sqarojnë gojarisht mendimin e komisionit.
- (9) Këshilli Drejtues i Odës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimt të njoftimit, do ta informoj kandidatit në lidhje me vendimin e Komisionit Vlerësues.

Neni 23

Taksat administrative

Për procedurën e specializimit te avokateve me vendimin e Këshilli Drejtues, caktohen taksat përkatëse administrative.

Neni 24

Pavlefshmeria dhe revokimi

- (1) Kompetent për shpalljen te pavlefshëm dhe revokimin e specializimit është Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve me propozimin e Komisionit Vlerësues.
- (2) Shpallja e pavlefshme dhe revokimi janë të lejuar vetëm brenda një viti, nga marrja në çfarëdo mënyre ne dijeni, nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve për faktet që i arsyetojnë.
- (3) Para marrjes së vendimit duhet të dëgjohet avokati. Vendimi i arsyetuar duhet t'i dërgohet avokatit.

Kapitulli IV

Dispozitat përfundimtare

Neni 25

Ri-certifikimi

1. Avokati që ka fituar specializimin në një degë përkatëse, çdo pesë (5) vjet do të aplikoj për ri-certifikim. Përkatësisht, avokati do të dëshmoj se:
 - 1.1 Gjatë çdo viti përgjatë 5 (pesë) viteve radhazi ka ndjekur kurse nga lëmia ku ka specializuar, të paktën të ketë fituar 4 kredi gjatë një viti.
 - 1.2 Gjatë çdo viti përgjatë 5 (pesë) viteve radhazi të ofroj dëshmi që nga totali i lëndëve ku ka ofruar ndihmë juridike, 25% e lëndëve i takon degës përkatëse ku avokati ka specializuar.
2. Në rast të mospërmbushjes së kriterëve të parapara nga paragrafi 1 i këtij Neni, me propozim të Komisionit, Këshilli Drejtues do të revokoj titullin e specialistit të degës përkatëse.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Ne vitin e pare nga data e hyrjes ne fuqi te kësaj rregullore OAK do te ofroj specializime vetëm ne lemitë;

1. E drejta penale
2. E drejta Civile
3. E drejta Komerçiale.

Neni 27

Rregullorja hyn ne fuqi ne ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe zbatohet nga data 1 Janar 2014.

Av. Ibrahim Z. Dobruna

Kryetari i OAK-së